



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Uprava za Poleprivredu, Sumarstvo i Ruralni Razvoj

Department of Agriculture, Forestry and Rural Development



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA**



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odejenja za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 3924 Më 13.08.2021
Br. prot. Dt.
RAHOVEC - ORAHOVAC

THIRRJE PËR APLIKIM

Përkrahje e fermerëve me mekanizëm bujqësor

Rahovec, Gusht 2021

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural fton të gjithë fermerët e Komunës së Rahovecit që të aplikojnë për grante në mekanizëm bujqësor.

• **Sektorët të cilët do të përkrahen përmes kësaj thirrje janë:**

1. Pemëtaria (vreshtaria),
2. Lavërtaria,
3. Perimekultura,
4. Blegtoaria,
5. Bletaria.

Kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojnë fermerët për përfitimin e grantit janë:

- Të jenë banor të Komunës së Rahovecit,
- Të jetë fermerë i regjistruar (NIF)
- Të kenë të shlyera obligimet ndaj Komunës,
- Të jetë i gatshëm / e gatshme të nënshkruaj kontratë me kushtet e Komunës
- Të posedojnë tokë bujqësore në pronësi apo të marrë me qira,
- Të mos jetë përfitues i granteve komunale në tre vitet e fundit,
- Të jetë i gatshëm të financoj 20% të vlerës së pajisjes,

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

- Aplikacioni (merret online ose në zyrat e DBPZHR-së),
- Kopjen e letërnjoftimit,
- Dëshmi mbi pronësi të tokës bujqësore,
- Vërtetim mbi shlyerjen e obligimeve ndaj Komunës së Rahovecit (Tatimi në pronë dhe taksa komunale).

1. Kriteret specifike që duhet të plotësojnë fermerët për përfitimin e Pllugjeve (2) krahëshe

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Të jetë fermer/fermere, kultivues i kulturave lavërtare dhe perimore.
- Të ketë të mbjellura kulturat lavërtare, si: Grurë, Misër, Elb apo Tërshërë së paku 1.00 ha
- Të ketë të mbjellura së paku 0.50 ha me perime.

2. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitim të Motokultivatorit (Benasi):

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Të jetë fermer/fermerë, kultivues i kulturave vreshtarë dhe perimore.
- Të ketë të mbjellura së paku 0.20 ha me vreshta apo 0.50 ha me perime.

3. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitim të Motokultivatorit me Frezë (GOLDON)

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Të ketë të mbjellura kulturat me perime së paku 3.00 ha, kulturat si: (spec, patate, qepë, pjepër, etj).

4. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët (vreshtarët) për përfitim të Kultivatorit (plugjë për vreshta)

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Të ketë së paku 0.50 ha me vreshta,
- Dëshmi nga DVV për sipërfaqe me vreshta

5. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitim të Spërkatëses 500 L

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Të ketë të mbjellura kulturat me perime së paku 1.00 ha,
- Të ketë të mbjellura kulturat lavërtare: Grurë, Miser, Elb dhe Tërsher 5.00 ha.

6. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitim të Frezës 1.6 dhe 1.8 mm për traktor;

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Të posedojnë tokë të punueshme bujqësore së paku 5.00 ha, kulturat lavërtare
- Të posedojnë tokë të punueshme bujqësore së paku 3.00 ha, kulturat perimore
- Të posedojnë tokë të punueshme bujqësore vreshta 2.00 ha, vreshta
- Të posedojnë tokë të punueshme bujqësore 1.00 ha pemë drufutore.

7. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitim të Pajisjes për Mulqerimin e hardhive dhe perimeve

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Të posedojnë vreshta së paku 1.50 ha,
- Të posedojnë perime së paku 3.00 ha,
- Dëshmi nga DVV për sipërfaqe me vreshta.

8. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitim të Pajisjes mbjellëse për Qepjuka 5 rende

Përveç kushteve të përgjithshme duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Të ketë të mbjellura së paku kulturat me perime Qepë dhe Hudher 1.00 ha.

9. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitim të Pajisjes mbjellëse të Misrit Pneumatike 4 rende

Përveç kushteve të përgjithshme duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Të kenë regjistrin e kafshëve të AUV-së
- Të posedojnë mbi 15 krerë lopë qumështore
- Të ketë të mbjellura së paku kulturat me misër së paku 5.00 ha.

10. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitim të Pajisjes mbjellëse për Patate 2 rende

Përveç kushteve të përgjithshme duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Të ketë të mbjellura së paku kulturat me patate së paku 1.50 ha.

11. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitim të Pajisjes Depozitor Plehu

Përveç kushteve të përgjithshme duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Të posedojë vreshta së paku 2.00 ha,
- Dëshmi nga DVV për sipërfaqe me vreshta.

12. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitim të Pajisjes Plugjë 5 brazësh

Përveç kushteve të përgjithshme duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Të posedojë vreshta së paku 1.00 ha,
- Dëshmi nga DVV për sipërfaqe me vreshta.

13. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitim të Pajisjes Roto Kosa 135 Farmers

Përveç kushteve të përgjithshme duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Të kenë regjistrin e kafshëve të AUV-së
- Të posedojnë mbi 15 krerë lopë qumështore
- Të posedojnë mbi 150 krerë dele dhe dhi.

14. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitim të Pajisjes Grabuja me Traka me kardan 2 mm

Përveç kushteve të përgjithshme duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Të kenë regjistrin e kafshëve të AUV-së
- Të posedojnë mbi 15 krerë lopë qumështore
- Të posedojnë mbi 150 krerë dele dhe dhi.

15. Kriteret që duhet të plotësojnë fermerët për përfitim të Pajisjes Centrifugë për mjaltë dhe shkrirëse e dyllit me avull

Përveç kushteve të përgjithshme duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Të jetë anëtar i shoqatës së bletarëve,
- Të posedojnë 50 shoqëri me bletë.

Vërejtje:

- *Përqindja e përkrahjes do të jetë 80% nga Komuna e Rahovecit dhe 20% nga fermeri,*
- *Pasi të shpallen përfituesit, të gjithë fermerët janë të obliguar që të kryejnë participimin prej 20% dhe të nënshkruajnë kontratën me Komunën e Rahoveci.*
- *Për specifikat e pajisjes fermerët do të informohen gjatë procesit të aplikimit.*

Afati i aplikimit nga data: **16.08.2021** deri më **03.09.2021**

Aplikacionet dorëzohen në drejtorinë e BPZHR-së, në objektin e vjetër të komunës së Rahovecit.

Aplikuesi /Fermeri	Zyrtari Komunal
----------------------------------	-------------------------------